





Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë  
Opstina Vitina  
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 14, 17 paragrafi 1, shkronja c, neni 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës), neni 21 të Ligjit me Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës (Gazeta Zyrtare Nr.10, prill 2019), neni 24, paragrafi 3 i Rregullores Nr.09/2020 për Caktimin e Procedurave për Dhënien në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës me Nr. të protokollit 02-035/02-1194, të datës 24.01.2022, Kuvendi i Komunës së Vitisë në mbledhjen e mbajtur më datën 28.10.2022, merr këtë:

## V E N D I M

**për plotësimin dhe ndryshimin e vendimit 01-110/05-110, të datës 01.02.2022 për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti**

### Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për plotësim ndryshimin e Vendimit me Nr.01-110/05-110 të datës 01.02.2022 për caktimin e lokacioni për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti.

### Neni 2

Sipas vendimit të cekur në nenin 1, plotësim-ndryshimi nënkupton:  
Ndryshohet neni 1 i vendimit bazë, hiqet caktimi i lokacionit dhe i shtohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme komunale në afatgjatë për 99 vite, dhënia jepet pa kompensim, mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohet me kontratë, e cila lidhet në mes kryetarit të komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit, prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.

### Neni 3

Pika tjera të Vendimit me Nr.01-110/05-110, të datës 01.02.2022 mbesin të pa ndryshuara.

### Neni 4

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimi dhe publikimi të akteve të Komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Kadastër, Pronë;
3. Gjykatës Themelore në Gjilan - Dega në Viti;
3. MAPL-së; dhe
4. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË  
K R Y E S U E S I

Bekim, Azizi

